



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA KRUIJË
DREJTORIA E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

Krujë më : 20 / 05 / 2026

Njoftim

"Për zbatimin e Ligjit nr.86/2025, "Për fshirjen, shuarjen dhe pagesën e detyrimeve tatimore ndaj administratës tatimore qendrore e vendore dhe e detyrimeve të pagueshme ne doganë"

I nderuar TATIMPAGUES!

Në zbatim të **Ligjit nr. 86/2025 "Për fshirjen, shuarjen dhe pagesën e detyrimeve tatimore ndaj administratës tatimore qendrore e vendore dhe detyrimeve të pagueshme në doganë"** dhe Udhëzimit nr 11 DATE 14.05.2026 të Ministrit së Financave, ju njoftojmë si vijon :

1. TATIMPAGUES /SUBJEKTE QE PERFITOJNE NGA LIGJI SIPAS PERIUDHAVE

- **Detyrimet deri më 31.12.2014:** Fshihen plotësisht.
- **Detyrimet për periudhën 2015–2019:** Mund te përfitoni nga shuarja e pjeshme/me kusht, sipas zgjedhjes suaj:
 - 50% e detyrimit fshihet, nëse paguani pjesën tjetër 50% te detyrimit brenda datës **30.06.2026**.
 - 25% e detyrimit fshihet, nëse paguani pjesën tjetër 75% te detyrimit brenda datës **31.12.2026**.
 - Në të dyja rastet, gjobat dhe kamatëvonesat fshihen plotësisht.
- **Detyrimet për periudhën 2020–2024:** Fshihen gjobat dhe kamatëvonesat, me kusht që të paguhet 100% i principalit deri më **31.12.2026**.

II. TATIMPAGUESIT/SUBJEKTET QË NUK PËRFITOJNË

1 Tatimpagues , të cilët janë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.

2- Janë në proces gjyqësor apo hetimi për vepra penale në fushën tatimore dhe/ose doganore,

3- Jane në proces ankimi administrativ ose gjyqësor për detyrimet tatimore/detyrimet e pagueshme në doganë.

III. TE TJERA

Tatimpaguesi/subjekti, i cili është në proces ankimi administrativ ose gjyqësor për detyrimet tatimore/detyrimet e pagueshme në doganë, i nënshtrohet këtij ligji, ***nëse ai heq dorë nga ankimi administrativ, ose nga e drejta e padisë/ankimit/rekursit në çdo fazë dhe shkallë të gjyimit pranë gjykatës administrative kompetente.***

Në momentin kur tatimpaguesi/subjekti paraqet pranë organit tatimor/doganor aktin e heqjes dorë nga ankimi administrativ ose nga e drejta e padisë/ankimit/rekursit, bëhet pjesë e shqyrtimit të ligjit, kur paraqitja e aktit nga ana e subjektit, ***nuk mund të jetë më vonë se data 30.11.2026.***

Për tatimpaguesit/subjektet për të cilët gjatë zbatimit të këtij ligji ***fillon një proces gjyqësor apo hetimor për vepra penale në fushën tatimore dhe/ose doganore, procedura e faljes, nëse është zbatuar, anulohet.***

IV. E RËNDËSISHME

Për këto periudha, pra për vitet 2015 deri më 2024, veprimi i parë i takon debitorit. Si fillim duhet te kryeni pagesën.
Në përshkrimin e pagesës specifikoni që pagesa po kryhet në bazë të ligjit të faljes.

V. KUJDES ME SHUMËN QË PAGUANI

Shuma që paguani për **principalin** e taksës apo tarifës vendore duhet të jetë e saktë sipas fashës ku përfshihet detyrimi juaj.
50% ose 75% për detyrimet 2015–2019.
100% për detyrimet 2020–2024.

VI. NA KONTAKTONI PËR ASISTENCË

Nëse keni paqartësi ose dëshironi konfirmim për shumën që duhet të paguani:
Na shkruani në drejtoriataksavekruje@yahoo.com
Ose paraqituni fizikisht pranë zyrave tona prane Nj. Administrative Fushe -Kruje

ADMINISTRATA TATIMORE VENDORE KRUJE